



Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindor - OFAP

KONFERENCË

Implementimi i projekteve gjatë vitit 2018

Prishtinë, 2019

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Projekti: Fuqizimi i strehimit familjar në mbrojtje të fëmijëve pa përkujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore - 2018

- **Objektivi i përgjithshëm:** Ofrimi i shërbimeve alternative dhe këshillave për zhvillimin e strehimit familjar.
- **Takime me KSHMS:** Janë realizuar tri takime me Kolegjiun KSHMS për mbështetje të fëmijëve në strehim familjar; Organizimi i punëtorive regjionale për hartimin e Planeve Komunale të Veprimit për Shërbimet Sociale.
- **Trajnimi i profesionistëve:** Ngritje e kapaciteteve të punëtorëve sociale për avokim dhe fuqizim të strehimit familjar. Janë trajnuar 35 staf i QPS-ve.
- **Punëtori me Staf:** Punëtori për fuqizimin e stafit të OFAP si dhe harmonizimin e metodologjisë së punës në realizimin e projekteve për strehimin familjar.
- **Takime me komunitetin:** Janë realizuar 12 takime me komunitetin si dhe 4 takime rajonale me familjet strehuese alternative dhe tek të afërmit.
- **Realizimi i takimeve me menaxher të rasteve në QPS:** Janë realizuar 110 kontakte dhe takime me shumicën e QPS-ve; Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Gjilan, Ferizaj, Malishevë, Vushtrri, Hani Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Shtërpçë, Mitrovicë, Prishtinë, Drenas, Junik, Deçan, Istog, Viti, Dragash, Therandë.
- **Realizimi i vizitave nga ekipa profesionale:** Janë vizituar 100 familje strehuese, 117 fëmijë, 50 kanë përfituar direkt nga seancat psikologjike dhe 67 këshilla psikologjike dhe rekomandime.

Projekti: Promovimi dhe zgjerimi i shërbimeve të strehimit familjar për të gjithë fëmijët në nevojë për komunat e përzgjedhura në Kosovë

- ▶ **Qëllimi: Fëmijët pa kujdes prindëror trajtohen dhe mbështeten nga QPS-të në përputhje me standardet minimale të shërbimeve për Strehim Familjar të miratuar nga MPMS.**
- ▶ **Rritja e kapaciteteve të 43 familjeve strehuese për t'u kujdesur për fëmijët e strehimit familjar.**
- ▶ **Çdo fëmijë në strehim familjar (55 nga janari 2018 dhe fëmijë të rinj të vendosur gjatë vitit 2018) kanë qenë pjesë e planit individual që nga momenti kur ata kanë hyrë në strehimin familjar.**
- ▶ **Të gjithë fëmijët në strehim familjar përfitojnë nga sesione individuale dhe psikosociale.**
- ▶ **1000 persona të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet ndërgjegjëse për strehim familjar.**
- ▶ **66 punonjës sociale të QPS-ve kanë përfituar nga trajnimi për standardet minimale të shërbimeve të strehimit familjar.**
- ▶ **Rritja e kapaciteteve të 25 punëtorëve social/ menaxherëve të rasteve të ekipit të QPS-ve dhe 25 gjyqtarëve për statusin ligjor të fëmijëve në strehim familjar.**
- ▶ **Përgatitja e planeve të veprimit në komunat ku mungojnë familjet strehuese në bashkëpunim me QPS-të.**
- ▶ **Takime sensibilizimi për familje të reja strehuese.**

Save the Children/SIDA

Projekti: Ti mbrojmë fëmijët nga dhuna në familje dhe në shkolla - 2018

- ▶ **Realizohet në dy Komuna: Ferizaj dhe Mitrovicë.**
- ▶ **Mbajtja e programit për Disiplinën Pozitive në Prindërimin e Përditshëm/PDEP:** Prindërit janë informuar për Disiplinën Pozitive e cila është jo e dhunshme dhe e bazuar në parimet e zhvillimit të fëmijës. Janë informuar 57 prindër.
- ▶ **Sesione informuese për nxënës:** Janë informuar me rolin e QPS dhe Policisë në Komunitet për mbrojtjen e fëmijëve. Janë informuar 129 nxënës.
- ▶ **Trajnim:** Për ngritjen e kapaciteteve në ofrimin e mbështetjes psikosociale nga eksperti i Save the Children, Marcia Brophy.
- ▶ **Ofrimi i këshillave psikosociale nga ekipa profesionale:** Fëmijët dhe familjet e riatdhesuara informohen dhe përfitojnë nga mbështetja psikosociale dhe institucionale për fuqizimin e kujdesit familjar. Janë vizituar 12 familje të riatdhesuara në Ferizaj dhe Mitrovicë.
- ▶ **Realizimi i punëtorisë dy ditore në dy Komuna për personat e riatdhesuar:** Shqyrtimi i pikave konkrete të Rregullores për të Riatdhesuarit drejt përmirësimit të situatës reale për familjet e riatdhesuara.
- ▶ **Kampanjat informuese për nxënësit:** Janë informuar për format e dhunës dhe të drejtat e tyre sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve. Janë informuar 156 nxënës.
- ▶ **Ngritja e kapaciteteve të Organizatës:** Trajnimi i stafit dhe familjeve strehuese për politikën e mbrojtjes së fëmijëve.

Projekti: Forcimi i shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë të vendosur në strehim familjar alternative dhe strehim familjar tek të afërmit – 2018

- ▶ **Realizohet në katër Komuna:** Prishtinë, Prizren, Malishevë dhe Gjakovë.
- ▶ **Realizimi i Raportit Hulumtues:** Është përqendruar në të dhënat për strehimin familjar alternativ dhe tek të afërmit në katër komunat e targetuara.
- ▶ **Takime me institucionet lokale:** Identifikimi dhe udhëzimet për përmirësimin e strehimit familjar alternativ dhe tek të afërmit për t'iu ofruar atyre shërbime më të mira.
- ▶ **Trajnimi i profesionisteve:** Janë mbajtur 4 ditë trajnim me punonjësit social, psikolog, edukator për menaxhimin e rasteve në planin individual për secilin fëmijë në strehim familjar.
- ▶ **Realizimi i vizitave nga ekipa profesionale:** Janë realizuar 64 vizita në familje strehuese, ndërsa 6 vizita në familje strehuese tek të afërmit. Është punuar 40/200 fëmijë (19 vajza dhe 21 djem) të grupmoshave 0-18 vjet. Këta fëmijë janë të vendosur në strehim familjar alternative dhe tek të afërmit.
- ▶ **Realizimi i fushatave sensibilizuese:** Janë realizuar 6 takime sensibilizuese për fuqizim të familjeve strehuese dhe mbrojtjen e fëmijëve, gjithashtu, janë mbajtur tri fushata në media.
- ▶ **Kontraktimi i psikologëve Komunë – OFAP:** Për ofrimin e shërbimeve psikologjike në QPS në këto Komuna: Prizren, Ferizaj, Obiliq, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë.

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

Projekti: “PIA - Përgatitje, Informim, Avokim” për krijimin e komunës mike për fëmijë në Komunën e Ferizajt

- ▶ **Realizimi i hulumtimit për të drejtat e Fëmijëve:** Perceptimi publik i fëmijëve, prindërve dhe Institucioneve të Komunës së Ferizajt për të drejtat e fëmijëve. Janë anketuar 400 respondent.
- ▶ **Mjeti i Vetëvlerësimit:** Adreson mënyrën se si komuna i përgjigjet nevojave të fëmijëve, si i bën politikat, strategjitë dhe planet, si punon me komunitetet dhe si e informon shoqërinë civile.
- ▶ **Hartimi i Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve përmes Sistemit Qeverisës Komunal**
Miqësor Për Fëmijët: Më 31 Maj 2018, është miratuar në Kuvendin Komunal të Ferizajt.
- ▶ **Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunën mike për Fëmijë (2019 – 2021):** Më 31 Korrik 2018, është miratuar në Kuvendin Komunal të Ferizajt
- ▶ **Përpilimi dhe shpërndarja e fletushkës në kuadër të fushatës sensibilizuese.** Janë informuar 1500 qytetarë.
- ▶ **Video sensibilizuese mbi të drejtat e fëmijëve.**

Ministria e Shëndetësisë

Projekti: Mbështetja shëndetësore për fëmijët pa kujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pas dore - 2018

- ▶ **Realizimi i Raportit Hulamtues:** Identifikimi i nevojave shëndetësore si dhe shërbimet shëndetësore që duhet të përfitojnë fëmijët, veçanërisht, fëmijët me nevoja të veçanta.
- ▶ **Sensibilizimi i qytetarëve:** Lidhur me rendësin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë fëmijët, me theks të veçantë për fëmijët me nevoja të veçanta. Janë informuar rreth 2000 qytetarë.
- ▶ **Realizimi i vizitave nga ekipa profesionale:** Janë realizuar 48 vizita në 27 familje strehuese alternative. Këshillim për zhvillimin e komunikimit të fëmijëve, ofrimi i mbështetjes profesionale për familjet strehuese.
- ▶ **Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për fëmijët me nevoja të veçanta në strehim familjar:** Numri i fëmijë me nevoja të veçanta është 15. Nëntë (9) prej tyre si raste më të rënda janë mbështetur drejtpërdrejt në rehabilitimin e tyre shëndetësorë, ndërsa, për të tjerët janë udhëzuar familjet strehuese për hapat që duhet të ndjekin në shërimin e fëmijëve.
- ▶ **Realizimi i takimeve informuese me Profesionistët Shëndetësor:** Janë realizuar 8 (tetë) takime në 8 (tetë) QKMF në Komunitet; Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Gjakovë, Prizren, Gjiçan, Ferizaj dhe Vushtrri. Janë informuar 231 Profesionistë Shëndetësor.
- ▶ Takim me Kolegjiun të KSHMS, takime të rregullta me QPS-të në të gjitha Komunitet e Kosovës, Qendrën e Asociacionit Nacional të Autizmit të Kosovës – ANAK, etj.

REKOMANDIME:

- ▶ Vazhdimi i takimeve informues me Profesionistët Shëndetësorë në të gjitha QKMF-të në Komunitet e Republikës së Kosovës.
- ▶ Vazhdimi permanent i ofrimeve të shërbimeve shëndetësore me theks të veçantë fëmijëve me nevoja të veçanta.
- ▶ Vizita të vazhdueshme fëmijëve në strehim familjar nga ekipa profesionale.
- ▶ Vizita e fëmijëve në familjet strehuese nga ekipa mobile e mjekeve për fëmijët e braktisur të porsalindur 0-3 vjeç.
- ▶ Ngritja e kualitetit të shërbimeve psikologjike për nënat potenciale për braktisjen e fëmijëve.
- ▶ Fushata sensibilizuese të vazhdueshme rreth strehimit familjar alternativ dhe strehimit familjar tek të afërmit.

FALEMINDERIT!